



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**VENDIM**

**Nr. 79, datë 26.11.2018**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM  
TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME ROSKOVEC**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 26.11.2018 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës Kanalizime Roskovec sh. a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

**Konstatoi se:**

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Roskovec është licencuar me vendimin e KKRR nr. 53, datë 23.11.2017, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Roskovec" pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Roskovec ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 165 prot. datë 29.06.2018, me lëndë " Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Roskovec kishte mangësi:

- “Seanca Dëgjimore me Publikun”, nuk ishte zhvilluar konform udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore ku të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ERRU.
- “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave.

ERRU ju drejtua shoqërisë me shkresën nr. 336/1 prot, datë 23.07.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Roskovec me shkresë nr. 226 prot, datë 21.09.2018 ka njoftuar ERRU-në për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me Publikun dhe me shkresë nr. 237 prot, datë 10.10.2018 ka dërguar proces verbalin e zhvillimit të saj.

Shoqëria UK Roskovec ka dërguar me shkresën nr. 253 prot, datë 05.11.2018 dokumentin e munguar “Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec mbi dhënien e mendimit për miratimin e nivelit të ri të tarifave”, protokolluar në ERRU me shkresë nr 459 prot datë 13.11.2018.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Roskovec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në Vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Roskovec për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Roskovec për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Ndriçim Shani**